

Hysen Sahit TËRPEZA (10.6.1910 - 23.6.2002)

Biografia



Hysen Sahit Tërpeza lindi më 10 qershor 1910, në fshatin Tërpezë të Komunës së Vitisë. Autodidakt, me një inteligjencë të theksuar natyrore, me një mbamendje të jashtëzakonshme, një luftëtar me pushkë në dorë, Komandant i forcave të armatosura për mbrojtjen dhe çlirimin e Kosovës nga ripushtimi i Serbisë më 1944-45, arriti të bëhet edhe një politikan dhe organizator i shquar dhe me ndikim në mërgatën shqiptare në botë, u bë një figurë emblematike e atdhetarit dhe e mërgimtarit.

Ai do të detyrohet të arratiset nga Kosova dhe me armë në dorë t'i çajë rrethimet, si dhe ta shpërthejë kufirin në Greqi në fund të vitit 1945, për të kërkuar strehim në këtë shtet bashkë me një grup jo të vogël bashkëluftëtarësh. Nga Greqia, ai shkoi në Itali, ndërsa në SHBA Hysen Tërpeza shkoi në vitin 1956. Aty, më 24 korrik 1967, e merr shtetësinë amerikane. Pas një veprimtarie të dendur dhe mjaft efektive në diasporën tonë në SHBA, Hysen Tërpeza, për të qenë më afër Kosovës, në fillim të viteve të 80-ta vjen në Evropë. Ardhjet e tij në Evropë shpeshtohen, veçanërisht pas demonstratave gjithëpopullore në Kosovë të vitit 1981. Por, vetëm pas rënies së Murit të Berlinit dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë, veçanërisht pas vitit 1992, ai vendos të jetojë dhe të veprojë në Zvicër. Vendosja e tij në Zvicër ishte një mbështetje e konsiderueshme për mërgimtarët. Ata e pritën kudo me entuziazëm, në banesat e tyre, në festat dhe vdekjet e tyre, në gëzimet dhe pikëllimet e tyre. E ftonin, dhe ai me kënaqësi shkonte nëpër manifestimet e ndryshme. Tërpeza nuk bënte dallime politike, fetare e krahinore. Përvoja e tij e jashtëzakonshme në luftëra të armatosura, në përleshje fytyfytytas me armiq, në përleshje politike me kundërshtarët, në debate dhe organizime politike për çështjen e Kosovës e bëri një personalitet të rrallë me njohuri solide për problemet e së kaluarës dhe problemet aktuale. Para mërgimtarëve tanë në Zvicër, mbante fjalime historike, politike, moralizuese, mbante fjalime trimërie e guximi, shembulli e sakrifice. Ashtu siç ishte në SHBA, edhe diasporën tonë në Zvicër

dhe në Gjermani, Hysen Tërpeza u bë krah i fuqishëm dhe një referencë e shkëlqyer, shembull dhe prototip i luftëtarit të guximshëm e i vendosur i popullit të vet, që ishte ngritur në luftë për lirinë e tij kombëtare.

Në vitin 1997, në përvjetorin e 87-të të jetës, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pikërisht në ditëlindjen e tij, më 10 qershor, iu dha me dekret presidencial URDHRI “GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU”, me motivacionin „NACIONALIST DHE DEMOKRAT I PAMPOSHTUR, SHEMBULL I GJALLË I LUFTËTARIT DHE I VEPRIMTARIT KONSEKUENT E TË PATREMBUR PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS DHE TË TROJEVE TONA TË ROBËRUARA”.

Themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe fillimin praktik të Luftës së Armatosur për çlirimin e Kosovës, Hysen Tërpeza e përjetoi si ngjarjen më të rëndësishme në jetën e tij. Ndërkaq, më 24 mars, ditën kur filluan bombardimet e NATO-s mbi Serbinë, Hysen Tërpeza, pikërisht në orën 19:40, kur kishin filluar bombardimet mbi Beograd, në një reportazh televiziv të një televizioni të Bernës, në Zvicër, do të japë deklaratë, në të cilën thotë: „Populli shqiptar ka vuajtur shumë. Shqiptarët e kanë pritur këtë ditë. Ata e meritojnë lirinë, sepse UÇK-ja bashkë me aleatët tanë, Amerikën dhe Evropën përparimtare, do ta heqin Serbinë pushtuese nga Kosova”.

Pas 55 vjetësh mërgimi, Hysen Tërpeza, me 89 vjetët e tij mbi supë, u kthye në Kosovë. Ishte një ditë korriku, ditë e nxehtë e vitit 1999, pa pushtuesit sllavë, ditë e lirë, e gëzuar. Një ditë e bardhë, si shpirti i luftëtarit të paepur e triumfues, si shpirti i Hysen Tërpezës, dhe po në një ditë të tillë, më 23 qershor të vitit 2002, ai vdiq në Kosovën e lirë. Hysen Tërpeza i kishte mbushur 92 vjet e 13 ditë.

Deri tash, përveç shumë intervistave të ndryshme nëpër gazeta dhe revista, publikime dhe transmetime televizive, më serioze, për jetën dhe veprën e Hysen Tërpezës janë botuar dhe emetuar:

Botime autoriale:

1. Hysen Tërpeza: „Ka me na gjykue Nana Kosovë”, Nju-Jork, 1976.
2. Hysen Tërpeza: „Tradhtia serbe, planifikimi i qeverisë jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve”, Gjermani, maj 1979.

Të tjerët për Hysen Tërpezën:

3. Mustafë Xhemali: "Hysen Tërpeza, luftëtar i Shqipërisë Etnike", intervistë në 13 vazhdime, “Kombi”, Prishtinë, 1997-1998.
7. Mustafë Xhemali: “Hysen Tërpeza – Një legjendë për Kosovën”, Publicistikë, Prishtinë, 2004.
4. Ilaz Metaj-Ali Llunji: "Hysen Tërpeza – histori e gjallë", monografi, Prishtinë, 1992.
5. „Toka nuk përfaqëson njerëzit, por njerëzit përfaqësojnë tokën", M. Xhemali, emision dokumentar, 30-minutësh, emetoi TVSH Satelitor dhe RTK.
6. “Hysen Tërpeza- një jetë për atdhe", A.Llunji, I. Metaj dhe N.Bytyçi, 3 pjesë nga 40 minuta, emetoi RTK.